

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës




EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

**PYETJE QË SHTROHEN SHPESH
NË LIDHJE ME ARKËTIMIN
DETYRUESHËM TË BORXHEVE**

A PARASHKRUHEN FATURAT E ENERGJISË ELEKTRIKE, UJIT DHE NGROHJES? ÇFARË DO TË THOTË PARASHKRIMI?

Faturat për këto shërbime të dhëna për ekonominë familjare parashkruhen për një vjet. Parashkrimi do të thotë se pasiqë të kalojë një vit nga pranimi i faturës për këto shërbime, dhënësit e shërbimeve nuk kanë të drejtë të kërkojnë arkëtim të borxhit.

Nga ana tjetër, **gjykata dhe noterët nuk kanë detyrim që të kujdesen nëse borxhi është parashkruar apo jo, dhe ky detyrim bie mbi ju.**

Nëse pranoni dokument “Aktvendim për lëshimin e urdhërpagesës noteriale me të cilën lejohet ekzekutimi i aktvendimit në bazë të dokumentit autentik” për borxh për të cilin konsideroni se është parashkruar, menjëherë dorëzoni kundërshtim te noteri i cili e ka lëshuar, duke theksuar se borxhi është parashkruar.

Këtu mund t’u ndihmojë avokati, nëse i përmbushni kushtet e përcaktuara me Ligjin për ndihmë juridike falas, zyrat rajonale të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe organizatat e regjistruara qytetare dhe klinikat juridike për sigurimin e ndihmës juridike falas.

Pyetje që shtrohen shpesh në lidhje me arkëtimin detyrueshëm të borxheve

MORA NJOFTIM SE NËSE NUK E PAGUAJ BORXHIN, DO TË KETË ARKËTIM TË DETYRUESHËM NGA ANA E PËRMBARUESIT. ÇFARË DO TË THOTË “ARKËTIM I DETYRUESHËM”?

Përmbaruesi është person i autorizuar që ka të drejtë të kryejë arkëtim të detyrueshëm të borxhit, që është vërtetuar me aktgjykim të plotëfuqishëm gjyqësor apo me Aktvendim me të cilin lejohet përmbarimi i aktvendimit në bazë të dokumentit të autentik, kurse ju nuk keni paguar borxhin në afatin të cilin e thekson aktgjykimi, respektivisht aktvendimi. Personi të cilit i keni patur borxh, në bazë të këtij dokumenti, ka parashtruar kërkesë për përmbarim deri te përmbaruesi i autorizuar.

Përmbaruesi ka të drejtë që realizojë “arkëtimin e detyrueshëm”, respektivisht pa kërkuar lejen tuaj, të arkëtojë borxhin nga llogaria e juaj bankare, nga prona e juaj e luajtshme apo e paluajtshme, në varësi nga lartësia e borxhit.

Përmbaruesi fillimisht kontrollon nëse keni mjete në bankë dhe nëse jeni të punësuar. Nëse nuk i arkëton

mjetet nga banka, mund të urdhërojë punëdhënësin tuaj që të mbajë 1/3 nga rroga.

Nëse nuk keni mjete dhe jeni të papunë, por keni pronë tjetër, përmbaruesi kryen vlerësim nëse ajo masë është përkatëse që të arkëtohet borxhi, dhe nëse është, mund të vijë deri te konfiskimi dhe shitja e pronës për arkëtim të borxhit.



KAM MARRË NJOFTIM SE LLOGARIA NË BANKË MË ËSHTË BLOKUAR NGA ANA E PËRMBARUESIT. ÇFARË DO TË THOTË KJO DHE ÇFARË DUHET TË BËJË?

Nëse përmbaruesi nuk gjen mjete të mjaftueshme në llogari që të arkëtojë borxhin, dhe i urdhëron bankës që të bllokojë llogarinë tuaj, që kur të pranoni mjete, në fillim të mund t'i shfrytëzohet përmbaruesi, aq sa është e nevojshme për mbylljen e borxhit.

Nëse keni mundësi, mund të paguani menjëherë borxhin, apo të përpigëni që lidhni kontratë me përmbaruesin për pagesën e borxhit në këste.





UNË JAM PERSON ME PENGESA DHE MARRË SHITESË PËR PENGESAT. A MUNDËT QË PËRMBARUESI TË MI MARRË KËTO MJETE?

Jo, **përmbaruesi në asnjë rast nuk mund të kryejë arkëtim të detyrueshëm mbi mjetet të cilat janë të paguara sipas këtyre bazave:**

1. të ardhura në bazë të mbajtjes ligjore, kompensim të demit të shkaktuar për shkak të çregullimit të shëndetit apo zvogëlimit, respektivisht humbjes të aftësisë të punës dhe kompensimi i demit për mbajtjen e humbur për shkak të vdekjes të dhënësit të mbajtjes;
2. të ardhurat në bazë të kompensimit për shkak të lëndimit trupor sipas rregullave për sigurim invalidor;

3. të ardhurat nga të drejtat e ndihmës në para nga mbrojtja sociale (ndihma e garantuar minimale, kompensim për shkak të aftësisë të kufizuar, kompensim të rrogës për punën me orar të shkurtuar, shtesa për banim, kompensim i përhershëm dhe ndihma e njëfishtë në para në pajtim me dispozitat nga mbrojtja sociale;
4. të ardhura në bazë të papunësisë të përkohshme;
5. të ardhura nga të drejtat për mbrojtje të fëmijëve në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve;
6. të ardhurat në bazë të bursës, kredisë, dhe ndihmës për nxënës dhe studentë;
7. të ardhurat e kadetëve të Akademisë ushtarake;
8. kompensim për punën e të dënuarit në shtëpinë ndëshkuese-korrektuese, përveç për kërkesë në bazë të mbajtjes ligjore si dhe për kërkesë për kompensim të demit të shkaktuar me vepër penale të të dënuarit;
9. të ardhura në bazë të shpenzimeve të rrugës;

Pyetje që shtrohen shpesh në lidhje me arkëtimin detyrueshëm të borxheve

10. të ardhura nga e drejta në siguri sociale për persona moshuar, në pajtim me rregullat për siguri sociale të personave të moshuar;

Megjithatë nëse ndodh që përmbaruesi të marrë këto holla nga Llogaria e Juaj, drejtoheni menjëherë me shkrim në zyrën e tij me njoftim prej ku e kanë prejardhjen ato mjete.

NJË MIK MA LUTI QË TË JEMI GARANT I TIJ PËR KREDI. SA ËSHTË KJO E SIGURTË, DHE CILAT JANË DETYRIMET E MIA?

Të jeni garant për kredi, domethënë të garantoni se ai person në kohë do të paguaj këstet e kredisë, dhe nëse ai person nuk i paguan, do i mbuloni ju në emër të tij.

Rrjedhimisht, nëse miku juaj vonohet me pagesën e kësteve, banka do të kërkojë nga ju si garant të paguani borxhin e tij.

Ju më tutje keni të drejtë që me padi të detyroni mikun tuaj të paguajë vlerën që ju keni paguar në bankë në vend të tij.



KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

- ✓ Shoqata dhe klinika juridike të cilat janë të autorizuarra për dhënien e ndihmës juridike falas
- ✓ Avokatë me kompetenca të fituara për dhënien e ndihmës juridike dytësore
- ✓ Në zyrat rajonale të Ministria e Drejtësisë (lista e kontakteve në shtojcë):

Njësitë rajonale	Telefonat
Berovë	071 205 324
Manastir	071 223 392
Makedonski Brod	071 223 075; 078 640 786
Vinicë	071 213 964
Vallandovë	071 213 925
Gjevgjeli	071 224 678; 071 216 267
Gostivar	071 223 180
Dibër	071 223 768
Delçevë	071 283 948
Demir Hisa	075 766 695
Kavadarë	075 659 855
Kërçovë	071 224 652
Koçanë	071 221 580
Kratovë	
Kriva Pallankë	071 224 580
Krushevë	071 227 808
Kumanovë	071 227 962

Njësitë rajonale	Telefonat
Negotinë	071 223 191
Ohër	071 221 908
Prilep	076 232 886
Probishtip	078 330 434
Radovish	070 261 310
Resnjë	071 221 246
Sveti Nikole	071 227 862
Strugë	071 223 015
Strumicë	071 224 526
Tetovë	071 227 893
Veles	
Shtip	071 221 484; 070 821 089
Karposh	071221381
Qendra	078 442 006
Kisella Vodë	071 224 104
Gazi Babë	071 213 798
Çairit	

Pyetje që shtrohen shpesh në lidhje me arkëtimin detyrueshëm të borxheve



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

www.pravnapomos.mk

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Drejtësisë